



KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES SE SIGURIMIT TE SHËNDETIT NE UDHETIM

Percaktime te pergjithshme:

1. Polica e sigurimit të shëndetit në udhëtim mbulon shpenzimet e arsyeshme dhe te domosdoshme ne rast:
 - Ndhme e shpejte dhe emergjente mjekësore te kryera si pasoje e nje gjendje te papritur dhe te paparashikueshme akute e cila pa trajtimin mjekesor brenda 48 oreve do te sillte vdekjen ose problem seriose te te siguruarit.
 - të riadhesimit, deri në vlerën maksimale të shpenzimeve të përcaktuara në formularin e policës së sigurimit si dhe në përputhje me zonën e zgjedhur të mbulimit,
 - emergjence shëndetësore, të shkaktuar si pasojë e një aksidenti apo sëmundje të papritur dhe të menjëhershme të ndodhur te siguruarit jashtë territorit të Shqipërisë gjatë periudhës së mbulimit në sigurim të përcaktuar në formularin e policës dhe për të cilën është paguar primi përkatës i sigurimit.

Ky sigurim është i vlefshëm vetëm për shtetasit të cilët në momentin e lëshimit të policës së sigurimit ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Polica e shendetit ne udhetim nuk mbulon shpenzimet per demet pasurore dhe jopasurore qe i shkaktohen te siguruarit por vetem shpenzimet spitalore dhe farmaceutike sipas kushteve te kontrates se sigurimit te shendetit ne udhetim.

Shpenzimet e kujdesit shendetesor do te perfshijne dhe kufizohen ne sherbimet e meposhtme:

- a) shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit ne nje dhome spitalore gjysem private, per perdorimin e trajtimit kirurgjikal, te dhomes se urgjences apo qendres mjekesore ambulatorore
 - b) Pagesa ndaj mjekut
 - c) Shpenzimet e kujdesit shendetesor ne ose jashte spitalit, perfshi: analizat laboratorike, sherbimet ambulatorore (administrimi i narkotikeve), mjekimi i pershkruar, mjekimi konservativ, anestezia (perfshi administrimin e lendeve anestetike), transfuzionet, anesite ose syte artificiale (perjashto riparimin ose transplantimin e ketyre organeve), radiografite
 - d) Shpenzimet per kujdesin mjekesor nga nje asistent i kualifikuar
2. **Sistemi mjekesor** ambulator: nje njesi e autorizuar mjekesore ose e kirurgjise ambulatorore, e ndryshme nga spitali, klinika ose dhome konsulence
 3. **Shpenzimet e arsyeshme** dhe te sakta te kujdesit shendetesor: jane pagesat dhe tarifat e aplikuar ne kete zone, kundrejt kryerjes se sherbimeve dhe mjeteve mjekesore te nevojshme per trajtimin e rasteve te ngjashme ne lloj dhe rendesi, por pa perfshire shpenzimet e procedurave qe nuk do te ishin te realizuara nese nuk do te ishte i siguruar . Kompania nuk do te paguaje asnje sasi parash pertej shpenzimeve te arsyetuara dhe te sakta te kujdesit mjekesor
 4. **Shuma e siguruar:** Shuma e miratuar dhe e cituar ne tabelen e ngjarjeve te Siguruara ne kontraten e sigurimit. **I siguruari ka te drejte te perfitoje dhe te kerkoje te demshperblehet vetem per nje nga llojet e mbulimit te percaktuar ne formularin e polices dhe brenda kufirit te mbulimit te percaktuar ne te.**
 5. **I Siguruari:** Cdo person i cili zoteron nje police sigurimi nga siguruasi, jo me i vjeter se 65 vjec ne te dhenat efektive te certifikates se sigurimit qe perfshin te dhenat e identifikimit. I siguruar nën moshën 16 vjeçare, në momentin e dëmit, dëmshpërblimi për vdekjen do të kufizohet në 1.000 Euro
 6. **Shtrirja territoriale:** Certifikata e Siguracionit eshte e vlefshme ne te gjithë boten me perjashtim te Shqiperise, vendbanimit te te siguruarit dhe vendit te nenshtetesise.
 7. **Aksidentet:** ngjarje e papritur dhe e paparashikuar qe rrjedh nga nje shkak i rastesishem violent ose i jashtem, pa vullnetin e te siguruarit, dhe qe ndodh gjate periudhes se vlefshmerise se certifikates se siguracionit, duke shkaktuar demtime trupore qe mund te percaktohen objektivisht dhe qe vene ne rrezik jeten ose rrjedhjen normale te udhetimit, ose qe rezultojne ne vdekje te te siguruarit.
 8. **Emergjence** do te konsiderohet gjendja qe mund te konstatohet ne rast aksidenti ose fillimi apo perkeqesimi papritmas i nje semundje te rende qe rezulton ne nje gjendje mjekesore qe kercenon ne menyre te menjehershme shendetin duke kerkuar ne kete menyre marrjen e masave mjekesore urgjente. Do te mbulohen vetem trajtimi mjekesore nga nje mjek i pergjithshem ose mjek specialist ose shtrimi ne spital brenda 24 oreve nga ndodhja e ngjarjes qe shkakton emergjencen.



“ATLANTIK” sh.a. - SHOQERI SIGURIMESH

9. **Gjendje para ekzistuese** : Cdo semundje ose plage qe :
 - Eshte diagnostikuar nga nje mjek apo ka kerkuar trjtim mjekesor perpara dates se fillimit te polices duke perfshire ketu edhe marrjen e ilaceve.
 - Ka shfaqur simptoma te brendshme perpara dates se fillimit te polices te cilat do ta detyronin nje person te kujdesshem qe te kerkonte keshillim apo trajtim mjekesor.
10. **Demtimi trupor**: Demtimi trupor, i jashtem dhe i paqellimshem qe ndodh papritur dhe menjehere dhe pavaresisht nga shkaqe te tjera te defekteve fizike ose paaftesive ekzistuese rezultat i aksidenteve, qe sjellin vdekjen ose hospitalizimin e te siguruarit.
11. **Semundja**: Cdo prekje e papritur somatike ose semundje duke perjashtuar cdo prekje ose semundje ekzistuese qe rezulton ose shkaktohet nga nje gjendje ose deficience per te cilen percaktohet, rekomandohet ose kerkohet, ose asistenca mjekesore duhet te ishte kerkuar ne menyre te arsyeshme ose perftuar perpara dates se fillimit te periudhes se vlefshmerise se certifikates se sigurimit.
12. **Semundje ngjitese** nënkupton çdo sëmundje që mund të transmetohet me anë të ndonjë sëmundjeje, substancë ose agjenti, nga një organizëm në një organizëm tjetër kur:
 - substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet në, një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshimi i tyre, pavarësisht nëse konsiderohet i gjallë ose jo, dhe metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo indirekte, përfshin, por nuk kufizohet në, transmetimin ajror, transmetimi i lëngjeve trupore, transmetimi nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngët ose gaz ose ndërmjet tyreorganizmat, dhe sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë lëndime trupore, sëmundje, shqetësime emocionale, dëmtime të shëndeti i njeriut, mirëqenia njerëzore ose dëmtimi i pronës.
13. **Ngjarja e siguruar**: Nje aksident, demtim trupor ose semundje bazuar ne kufizimet e mesiperme. Njoftimi per ngjarjen duhet te behet detyrimisht brenda 48 oreve ne adresen e emailit: info@atlantik.com.al dhe /ose ne nr e tel 00355 42 230 506.

Ne te gjitha rastet pjesa e zbriteshme do te jete sipas kushteve te formularit te polices.

PERJASHTIMET (RISKU I PAMBULUAR)

Kjo police sigurimi nuk mbulon:

1. Shpenzimet e bera ne Republiken e Shqiperise.
2. Shpenzimet e bera nga I siguruari 1 muaj pas dates se perfundimit te periudhes se sigurimit; 1 muaj mbas datës së diagnostikimit ose fillimit të trajtimit mjekësor; pas kalimit te 15 diteve nga data e diagnostikimit ose fillimit te trajtimit mjekesore.
3. Shpenzimet e riatdhesimit që bëhen pa miratimin e Shoqërisë
4. Shpenzimet ne rast te nje semundje te brendshme qe nuk lidhet me aksidentin, te nje semundje qe mund te klasifikohet si gjendje para ekzistuese, por shenjat e saj mund te jene shfaqaur perpara leshimit te polices se sigurimit; semundje shkaktuar gjate ose si rezultat i semundjeve veneriane ose komplikacioneve te saj, si dhe tumoret dhe kanceret, semundjet ngjitese, pandemite , epidemite etj ; semundjeve te tilla si AIDS ose HIV dhe / ose cdo semundje tjetere e lidhur duke permendur semundje pasuese ose forma te ndryshme te saj, pavaresisht menyres se marrjes ose shkaktimit te ketyre semundjeve. Eshte i siguruari ai qe duhet te kete gjithmone pergjegjesine e proves qe demtimet trupore ose semundjet nuk jane shkaktuar ose kane rezultuar si pasoje e AIDSs.
5. Ne rast kur nje person i siguruar ka mbushur moshen 65 vjec, perpara leshimit te polices se sigurimit.
6. Ne rast te nje demtimi trupor ose semundje shkaktuar:
 - nga nje lufte civile ose nje lufte me nje shtet tjetere, ose te induktuar nga i Siguruari;
 - te shkaktuar me dashje ose ekspozimi i ndergjegjshem ndaj nje rreziku (perjashto kur eshte perpjekje per te shpetuar nje jete njerezore), vetedemtimet, vetevrasjet ose perpjekjet per vete vrasje, ose si konsekuence e refuzimit per te ndjekur nje keshille mjekesore, ne rast te nje aksidenti dhe i siguruari eshte personi shkaktar, nese eshte shkaktar per gjendje te tilla
 - ne kohen kur i siguruari eshte nen influencen e alkoolit ose si konsekuence e tij, perdorimi i drogave ose narkotikeve, vetem nese jane rekomanduuar nga mjeku ose administruar nga ky i fundit



“ATLANTIK” sh.a. - SHOQERI SIGURIMESH

7. Ne rast te nje demtimi trupor ose semundje shkaktuar gjate ose si nje rezultat i pjesemarrjes se tij ne aktivite sportive si profesionale dhe amatore te te gjitha llojeve ose si rezultat i pjesemarrjes se tij ne gara ose stervitje me mjete detare, ajrore apo tokesore, ose si rezultat i perdorimit te nje motociklete ose scooter me nje kapacitet cilindrik mbi 125 c.c; i pjesemarrjes ne cdo lloj sporti te rrezikshem si hedhja me parashute, fluturime me mjete volante, paranavigacioni, ski ekstreme, ski jashte teritoreve normale, alpinizem, ngarja e mjeteve motorike te rrezikshme, shpellalogjia etj; fluturimeve me avion (perveç kur udhëton vetëm si pasagjer), duke përfshire zbritjen e ngadalshme, parashutimin, ushtrimin e sporteve dimërore,
8. Shpezimet ne rast te nje demtimi trupor ose semundje shkaktuar gjate nje vepre penale te percaktuar nga Kodi Penal apo veper e denueshme nga legjislacioni i zones se mbulimit
9. Shpezimet mjekesore nga shtatezania ose ne momentin e lindjes.
10. Shpenzimet e bera per kurimin e nje demtimi trupor ose semundje shkaktuar gjate ose si rezultat i nje pjesemarrje aktive ne nje konflikt te dhunshem, kryengritje ose luftime civile ose probleme publike ose gjate sherbimit ushtarak ose gjate detyres si nje roje ose nje kursi trainimi ne ushtri ose polici, ose grupe paramilitare, pavaresisht nese demtimet trupore ndodhin gjate lenies ose ne mungese ose dhe jo gjate sherbimit ose si pasojë e një aksidenti të ndodhur në vendin e punës, nëse personi i siguruar ushtron një aktivitet punësimi jashtë Shqipërisë gjatë periudhës që kjo policë është në fuqi.
11. Shpenzimet per kurimin e depresionit, ankthit, gjendjeve mendore, psikologjike apo nervore ose psikike, pavaresisht klasifikimit te tij, ne rast crregullimesh te sferave te mesiperme, depresion i cfaredolloj natyre, ose devijim mendor, cdo terapi psikoanalitike ose psikologjike, cdo shqetesim emocional,
12. Shpenzimet per demtime trupor ose semundje shkaktuar gjate ose si rezultat i frakturave patologjike ose cdo lloj terapie ose qe trajton konsekuencat e demtimit trupor ose semundjes dhe qendrojnë ne institucionet per trajtim mjekesor (shtepi, qendra rehabilitimi dhe detoksikimi etj), venie, ndërrim e riparim të çdo tipi proteze, karroce invaliditeti; testeve kozmetike strikte, kirurgji ose terapi, kirurgji plastike etj.
13. Shpenzime të pretenduara nga një Person që udhëton në kundërshtim me këshillën e mjekut ose shpenzime jo te rekomanduar nga nje mjek i aprovuar.
14. Shpenzimet per trajtim okulistik, syze, lente optike, procedura auditive, stomatologjike ose prostetike, perjashto ato qe jane konsekuence direkte e ngjarjes se siguruar. Rastet urgjente dentare, paguhen jo më shumë se 100 Euro pas aplikimit të pjesës së zbritshme
15. Perjashtohet mbulimi nga kjo police sigurimi për çdo humbje, dëmtim, kosto ose shpenzim që rrjedh direkt nga transmetimi ose transmetimi i pretenduar i:
 - a) Sëmundja e koronavirusit (COVID-19);
 - b) Sindroma e Rëndë e Frymëmarrjes Akute Coronavirus 2 (SARS-CoV-2); ose
 - c) Çdo mutacion ose variacion i SARS-CoV-2;

I siguruar ka detyrimin qe nese hyn ne nje spital ose klinike si pacient, te njoftoje brenda 48 oreve nga pranimi, siguruesin ne adresen e emailit: info@atlantik.com.al dhe /ose ne nr e tel 0035542230506. Ne te kundert, siguruesi do te mbuloje shpenzimet mjekesore deri ne 500 euro duke ulur shumen fikse te zbritshme.

ATLANTIK Sh.A